

Subjekti zhvillues detyrohet të paguajë diferencën apo shtesën përkatëse në vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në rast se rishikimi/ndryshimi i projektit, sipas Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 31, datë 10.06.2021 “Për disa ndryshime në disa vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe delegimin e kompetencave”, shoqërohet me rritjen e shumës së kësaj takse, që subjekti ka paguar në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit nga Bashkia Tiranë, në përputhje me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunksionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet rrugës “28 nëntori” dhe rrugës “Abdi Toptani, Bashkia Tiranë”.

### NENI 3

Të gjitha kushtet e tjera, si dhe të drejtat e detyrimet e palëve që janë përcaktuar në “Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Bashkisë Tiranë në datë 02.02.2018, mbeten të pandryshuara.

### NENI 4

Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

### NENI 5

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

### NENI 6

Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.

Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

**PALËT**

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**

**BASHKIA TIRANË**

Përfaqësuar nga,  
**Z. ERION VELLAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MARRËVESHJE**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN PËR DELEGIMIN E  
KOMPETENCAVE TË NËNSHKRUAR MES KËSHILLIT KOMBËTAR TË  
TERRITORIT DHE BASHKISË TIRANË, NË DATË 02.02.2018”**

Sot, më datë 10.06.2021, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Tiranë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7 shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të KKT-së Nr.10, datë 02.02.2018, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**

Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, të miratuara me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunksionale 4, 5, 11 dhe 21 kate, me 3 kate nëntokë “Book Building”, ndërmjet rrugës “28 nëntori” dhe rrugës “Abdi Toptani, Bashkia Tiranë”, zëvendësohen me dokumentet bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.31, datë 10.06.2021 “Për disa ndryshime në disa vendime të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe delegimin e kompetencave”.

**NENI 2**